



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 mars 2011
Nr. ref.: RK 81/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 74/09

Parashtruesi

Feti (Hamëz) Gashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit Rev. nr. 184/2008 të datës 27 janar
2009 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Feti (Hamëz) Gashi me banim në Mramur, Hajvali.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston aktgjykimin Rev. nr. 184/2008 të datës 27 janar 2009 të Gjykatës Supreme të Republikës Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon që e drejta e tij në punë e mbrojtur me Kushtetutë, është shkelur nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe vendimi i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm - Kushtetuta), neni 20 i Ligjit nr. 03L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm - Ligji) dhe neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm - Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 dhjetor 2009 parashtruesi ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
6. Kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme dhe Zyrës ligjore të KEK-ut, dhe Gjykata Kushtetuese nuk ka pranuar asnjë koment substancial deri më tani.
7. Më 15 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjqtares raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarit Altay Surroy (kryetar i kolegjit), Kadri Kryeziu dhe Gjylieta Mushkolaj i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi ka qenë i punësuar, si elektroinstalues, në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) në Prishtinë. KEK-u ka ndërmarrë procedurë disiplinore kundër parashtruesit për shkak të marrjes së paautorizuar të një transformatori elektrik, pronë e KEK-ut.
9. Në mbrojtje të tij, parashtruesi e ka mohuar marrjen e transformatorit pa leje dhe ka argumentuar që puna e kryer ka qenë jashtë orarit të punës dhe me pëlqimin e zyrtarëve të KEK-ut.
10. Më 28 prill 2004, Komisioni disiplinor i KEK-ut mori vendim dhe vlerësoi që parashtruesi i kishte shkelur detyrat e tij të punës dhe si rrjedhojë ia ndërpreu kontratën e punës.
11. Parashtruesi e kontestoi vendimin e sfiduar të Komisionit disiplinor të KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Më 24 nëntor 2006, Gjykata Komunale shpalli aktgjykimin e saj (Cl. nr. 166/2006) dhe dha urdhër për kthimin e parashtruesit në punë.
12. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale u apelua nga KEK-u në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila më aktgjykimin AC. nr. 173/2006, të datës 6 qershor 2007 e hodhi poshtë ankesën e KEK-ut, si dhe miratoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

13. KEK-u apeloj këtë aktgjykim në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila me aktgjykimin e saj Rev. nr. 184/2008, të datës 27 janar 2009, pranoi revizionin e KEK-ut dhe rrëzoi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale, duke mbështetur shkarkimin e parashtruesit nga punësimi në KEK. Gjykata Supreme konstatoi që Gjykata Komunale kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur e kishte vlerësuar padinë e parashtruesit si të bazuar.
14. Pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, më 11 mars 2009, KEK-u ndërpreu kontratën e punës së parashtruesit për shkak të "miratimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik – revizionin e të paditurit KEK nga Gjykata Supreme".

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

15. Për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi ka plotësuar kërkesat e lejueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, si dhe më tutje të specifikuara në ligj dhe rregullore.
16. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të ligjit i cili parashikon si në vijim:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht».
17. Nga dokumentet e parashtruara, duket që kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor sipas nenit 49 të ligjit.
18. Gjykata vëren që vendimi përfundimtar, pra aktgjykimi i Gjykatës Supreme, është marrë më 27 janar 2010 si dhe është zbatuar nga KEK-u më 11 mars 2009. Gjykata, gjithashtu vëren që parashtruesi ka parashtruar kërkesën tek Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese më 19 dhjetor 2010.
19. Kështu, Gjykata konkludon që kërkesa duhet hedhur poshtë si e palejueshme, në bazë të nenit 49 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës, njëzëri,

VENDOS

- I. TA HEDHË kërkesën si të papranueshme;

Ky vendim i komunikohet palëve dhe publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese



Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani